

Gjatë fushatës elektorale për zgjedhje komunale 2017, Demokraci Plus u ka kërkuar kandidatëve për Kryetar të shtatë komunave që të zotohen formalisht se do t'i përmbahen disa parimeve bazë të qeverisjes së mirë nëse zgjidhen për të udhëhequr komunën.

Inkurajuese ishte fakti se pothuajse të gjithë kandidatët për kryetarë për Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjakovë, Gjilan dhe Mitrovicë e nënshkruan dokumentin me gjashtë parime bazë të qeverisjes së mirë të quajtur “Gjashtë Zotimet për Qeverisje të Mirë Komunale.”

Ndër nënshkruesit e këtyre zotimeve janë edhe kryetarët aktual të këtyre shtatë komunave. Këto gjashtë zotime janë përzgjedhur dhe përpiluar me kujdes nga ekipi i Demokraci Plus duke u bazuar në përvojën e përcjelljes së institucioneve komunale si dhe analizën mbi parimet bazë për qeverisje të mirë.

Qëllimi i këtyre zotimeve është të instalojë një qeverisje në komunë që është e hapur, transparente dhe llogaridhënëse për qytetarët dhe grupet e interesit.